



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDIM

Nr. 37, datë 21/12 /2016

**PROPOZIM PËR PËRFITIM PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 21.12.2016 në zbatim të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", neni 5, (i ndryshuar), VKM –së Nr.429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme", pika 4 dhe 5, si dhe kërkesës së Z. Agron Dine për përfitim Pensioni të Posaçëm Shtetëror,

**VENDOSI;**

1. T'i propozojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhënien e Pensionit të Posaçëm Shtetëror **Z. Agron Qani DINE**, për kontribut të çmuar në zhvillimin e artit shqiptar, nëpërmjet pikturës së tij.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT**

**Sadri DANAJ**



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me Nr. \_\_\_\_\_ Prot, datë \_\_\_\_\_.201\_\_.